



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 94, datë 06.09.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 81000000 LEKË PËR LIKUJDIMIN**  
**E DETYRIMEVE NDAJ OSHEE**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji Nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe Projektbuxhetin Afat Mesëm 2022-2024”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 81000000 (tetëdhjetë e një milion) lekë për likuidimin e detyrimeve ndaj OSHEE.
2. Efekti financiar sipas pikës 1, do të sigurohet nga fondet e paprokuruara të objekteve të mëposhtëme:

<b>Programi buxhetor</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Fondi në lekë për vitin 2022</b>
04520	Rikualifikimi dhe elementë urban në bllokun e parafabrikateve L.18 (loti I)	45.000.000
09120	Ndërtim shkolla 9 vjeçare “Met Hasa”	36.000.000
	<b>TOTALI</b>	81.000.000

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

### **ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Zamira Mustafaraj**



**U shpall sot me datë 07.09.2022**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PREFEKTI I QARKUT Durrës**

Nr. 700/prot.  
4

Durrës, më 09.09.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**  
**Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË**  
**Durrës**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.94 datë 06.09.2022

“Për miratimin e përdorimit të fondit prej 81000000 lekë për likuidimin e detyrimeve ndaj OSHEE”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

